



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Puke, me 12.12.2025

Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik "Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026" të Bashkisë Pukë

Titulli i Projekt-aktit : "Mbi draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026" Grupet që u konsultuan: Banorët e të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme te interesit, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime : 129 persona, nga të cilët 17 gra dhe vajza

Numri i rekomandimeve: 51 Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimet publike ishin kryesisht mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale,
- Mirëmbajtjen e urave ekzistuese ne fshatra dhe ndërtimi i urave të reja,
- Rikualifikim urban në disa lagje të qytetit
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
- Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe rendeve të ujit dhe ndërtimi i rendeve të reja
- Përmirësimin e shërbimeve publike, ujësjellësi në disa fshatra,
- Përmirësimin i sinjalistikës rrugore,
- Mirëmbajtjen e varrezave publike,
- Me shumë fonde dhe vemendje për emergjencat civile

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web dhe facebook të Bashkisë Puke.

Sekretari i keshillit

Hazbi Terbuni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal i degjeses publike “ Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe buxhetit afatmesem 2026-2028 ”

Data : 21/11/2025 **Ora :** 11:00 **Vendi:** Njesia administrative Gjegjan

Numri i pjesëmarrësve : 24 , 19 burra dhe 5 gra

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : “ Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe buxhetit afatmesem 2026-2028 ”

Të pranishem ne takim: Zv/Kryetari i Bashkise Ferit Rrugaj, Drejtoresha e Menaxhimit të Financave Fiqirete Latifi , Drejtori i Burimeve Njerëzore Sokol Gjoni, Administratori i Njesise Adm. Gjegjan Pavlin Lalaj, Sekretari i Këshillit Hazbi Tërbuni, shefja e sektorit te Tatimeve/Tarifave Gjyste Marku, punonjës të njesisë Adm Gjegjan dhe banorë të njesisë Adm Gjegjan.

Takimi drejtohet nga Z. Ferit Ringaj Zv.Kryetari i Bashkise i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit

Ne vijim e mori fjalën Paulin Lalaj , Administratori i Njesise administrative Gjegjan , i cili prezantoi prioritetet dhe Investimet si vijon:

Gjegjan qender

- Varrezat e fshatrave
- Rikonstruksioni i rrugës në Haxhiaj
- Sigurimi i ngrohjes ne shkolla.
- Rikonstruktimi i rrugës së Gjegjanit, i godines se njesise dhe i pedonales.
- Uje vadites i demtuar ne Dom
- Riparime ure, ne Dom Përshpalaj

Kuzhnen

- Riparimi i rrugës dhe ura Rras – Fan
- Restaurimi i rrugës Sherraj
- Restaurimi i rrugës Koloj
- Ndërtimi i shesheve te Varrezave dhe restaurimi i Varrezes
- Ndërtimi i nje ure në Bardhaj
- Rruga ne Gojanin e vogel
- Rruga Ceraj
- Ndërtimi i rrugëve të reja

Gojan i Madh

- Tumbina
- Ndërtimi i zgjerimi i rruges
- Asfaltimi i rrugëve .
- Rikonstrukcion i shkollave.

Shkoze

- Restaurimi i rrugës kryesore, rruges Sulaj,
- Zgjerimi i varrezave te fshatit.
- Te realizohet ndricimi i rruges kryesore.
- Riparime ure dhe asfaltim
- Kerkohet baze materiale: tabela, banderola, lloje materialesh per punonjesit e sherbimeve.
- Kerkohen nga bonoret
- Zv. Kryetari Ferit Ringaj falenderoi Administratorin dhe prezantoi Projekt - Buxhetin 2026 duke u bere me dije banoreve per t' ju ofruar zgjidhje sa me shume problematikave te tyre.
- Kemi bere me dije qe ju eshte dhene zgjidhje disa problematikave: hapje rruges, ndihma ndertuese, ndricim rruge, sherbimeve, fokusohemi te hapja e rrugeve dhe Rikonstrukcion urash (Kuzhnen)
- Presim nga Fondi Zhvillimit dhe Emergjencat civile ten a krijojne mundesi per nderhyrje te metejshme.
- Jemi mbledhur per te ju degjuar ju dhe per te pare vemendjen tek ju nga Kryetari dhe Bashkia.
- Falenderoi edhe Elvin Hoxhen per pjesemarrjen nga Bashkia e qytetit dhe per ndihmesen qe n aka dhene ne hartimin e planeve vendore.

PJETER LALAJ Fshati DOM

- Ka kërkuar prej dy vitesh të kem zhavor për riparimin e rrugëve , që krijojnë mundësi levizje në fshatin Dom.

PASHK KOLA GJEGJIAN

- Ka një devijim të kanaleve të kullimit dhe atyre vaditese, nga perroi të kanali vadites , që ndikon negativisht të bujqësia, uji përdoret për vaditje , por jo për kopshtet. Problemi është balta dhe era e keqe në rrugë. Problem janë dhe shembjet në rrugë.

ZEF NIKOLLI KALIVARE

- Problem rrugët për rikonstruksion, perroi i thate don një ure, pasi është problem. furnizim me ujë për të gjithë fshatin, pasi ka mundësi të bëhet përmes Beralbit. Ndricimi për fshatin Kalivare.

Bardhok Ndoi KIMEZ

- Ankese në lidhje me Beralbin , për 25 vjet askush nuk e ka shikuar si problem .

GIOVALIN SHERRI Kryeplak

- Duam që problematikat në të gjitha zonat të shihen cilat janë me të domosdoshme. Për mua janë problem varrezat e fshatit kalivare. Kërkesa kryesore strehe prane varrezave për shërbesat për personat e vdekur, sigurimi i ujit të varrezat. Ktheni sytë nga Gjegjani.

KASTRIOT KECI

- Turbinat në rrugët Mesul duken me të medhaja.

MDUE GjERGJI

- Linja e ujit në fshatin Kuzhnen duhet ndërtuar.

GJIN LUKA

- Riparoni mulliri.
- Kazanet l shkaktojme në makine me lopata , duhen kosha të ri.

Mbylli takimin administratori

Mbajtësi i portokollit

Florinda Laçi

Sekretari i keshillit

Hazbi Terbuni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal : Konsultim publik : Ne Njesine administrative Rrape

Data : 21.11.2025 **Ora :** 13:00 **Vendi:** Salla e njesise administrative Rrape

Numri i pjesëmarrësve : 18 vete 15 burra dhe 3 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026 , NJ.A.Rrape

Pjesëmarrës : Ferit Ringaj zv/ kryetar , Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Florida Laci , specialiste finance, Sokol Gjoni drejtor i burimeve njerezore, Hazbi Terbuni , sekretar i keshillit bashkiak, Pellumbesha Lasku , administrator i Nj.A.Rrape.

Takimi drejtohet nga Zv/ kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025 dhe prioritetet per vitin 2026, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet janë si vijon :

Zv/ kryetari Ferit Ringaj : Po shpalosim prioritetet per vitin 2026 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025.

Nuk kemi ndonjë buxhet të madh por po hartojmë projekte në kuader të funksionimit të institucionit. Po bëjmë projekte për rrugë, shërbime në pyje, prita malore etj dhe të punesohen sa më shumë banorë. Kërkojmë të degjojmë nga ju problematika konkrete , të domosdoshme që të mund t'i planifikojmë dhe t'i zgjidhim. Ketu do të flasim për të gjithë sektorët si arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së jetës.

Realizimi i projekteve të mëdha kërkon mbështetje nga shteti, por projektet e vogla jemi munduar t'i realizojmë me nderhyrjen e duhur. URA e Kabashit ka nevojë për nderhyrjen e duhur . Sot jemi ketu çfarë mund të bëjmë në 2026 në Nj. Rrape për realizuar kërkesat tuaja.

RROK DEDA : Problemet e fshatit tim vitet e fundit janë plotësuar, tuba, vija, dritat për ndricim. Kërkojmë bjellorus pasi terreni është i vështirë. Duhet fadrome për kohen e keqe , pasi është problem për të gjithë fshatrat. Rruget janë problem në çdo cep të komunes edhe pse është punuar perseri ka nevojë.

Mustaf Furriku kryeplaku i Meçës: Kam paraqitur disa probleme që na perkasin të gjithëve. Rruga Mece nuk ka punëtor mirëmbajtje. Nuk na është dhënë asnjë fond neve si kryepleq, shteti i jep fondet e ne nuk i marrim. Ura dhe rruga e Kroveve është jashtë funksionit. Puka duhet të ketë televizor për të paraqitur çdo ditë ndodhite e ndryshme që ndodhin.

Bledar Qollaku: kryeplak Kabash. Fshati Kabash ka nevojë për nderhyrje kryesisht ura, rrugë, ku rrezikohet jeta e njerezve. Situata është shumë e keqe për të levizur edhe në kembe jo më me makina. Ujesjellesi është demtuar, qekur është ndertuar ujesjellesi i Pukes për pasoje nuk ka ujë. Nuk e dime a ka punëtor mirëmbajtës rruga e Kabashit.

Uke Gega : Banor i fshatit Buhot; Problem rruga që shkon të varrezat 700 m nga komuna, rruga është e prishur dhe shumë e ngushtë.

Pal Suli banor i fshatit Lumzi: Kam bërë kerkese që në 2023 për të lidh dy segmente rrugë malore. Me ndërru vendin shtyllave të dritave në rrugën kembësore. Segmentet e rrugës kanë nevojë për pastrim. Kërkohej të shtohen punëtor për pastrimin e rrugës.

Besnik Frroku. Lumzi: Janë vetëm 400 m rrugë për të lidhur dy lagjet.

Ferit Ringaj:zv/kryetari: hapja e rrugeve te reja eshte problematike per aresye procedure dhe duhet me marre leje dhe te diskutohet me sherbimin pyjor , te cilet duhet te marrin aprovim nga Ministria e Mjedisit.Ne po perpiqemi ta integrojme ne planin e emergjencave civile, pra nuk mungon vullneti i kryetarit , por jane procedurat ligjore. Nje rruge per tu hapur ka nevojte te zbatohen procedurat.

Zef Marku: Pse ka veshtersi te hapet rruga , qe ka nisur prej vitesh. Mirembajtja e rruges se Lumit zi. Firma don ta beje , por pengon leja , qe duhet te zgjidhet nga Bashkia.

Administratorja; Nuk jam kunder pyjeve , por duhet te zgjidhet problem i rrugeve.

Zv/ Kryetari: Do te shfrytezojme cdo hapsire per te gjetur zgjidhje.

Leke Luka: Blinisht; Rruga dhe ura , sepse jane prishe derrasat dhe kane mbetur hekurat, duhet te sillen derrasat.

Ahmet Kadana: Qendra administrative nuk ka trotuare dhe ndriçues

Administratorja: Nuk ka ndriçues ne njesine tone.

Zv/ kryetari: Eshte problem infrastruktura.

Nikoll Thekna : Breg: Ka dy vjet qe nuk ka investime ne Breg , vec punes se punetoreve. Ures i kane dale hekurat, uji i pijshem , varrezat demtohen sepse nuk jane rrethuar, emergjent hapja e rruges, kanali vadites nuk eshte rregulluar

Zv/kryetari: varrezat jane problematike , konflikt pronesie, duhet te zgjidhet konflikti nga kryetari i fshatit te trajtohet me prioritet zgjidhja e konfliktit dhe pastaj mund te behet rrethimi i varrezave.

Protokolloj

Florida Laci



Sekretari i keshillit

Hazbi Terbuni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal i Konsultimit publik : *Ne Njesine administrative Qelez*

Data : 25.11.2025 **Ora :** 10:00 **Vendi:** Salla e njesise administrative Qelez

Numri i pjesëmarrësve : 24 vete 20 burra dhe 4 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026 , NJ.A.Qelez .

Pjesëmarrës: *Denisa Meci, sekretare e pergjithshme, Sokol Gjoni drejtor i burimeve njerezore Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, , Bibe Kolaj, administrator i Nj.A Qelez, Alban Lleshi anetar keshilli, kryepleqte e fshatrave.*

Takimi drejtohet nga Denisa Meci , Sekretare e pergjithshme , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025 dhe prioritetet per vitin 2026, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën , diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Denisa Meci : Po shpalosim prioritetet per vitin 2026 dhe sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025. Sot administrata e bashkise eshte ketu per te degjuar ankesat

dhe kërkesat tuaja. Jemi ketu per te degjuar ankesat tuaja dhe te angazhohemi per zgjidhjen e tyre.

Sokoli Gjoni – Pershendetje takimi me banore te njesise për project- buxhetin 2026, problematika, te njesise per ti zgjidhur

Te jemi te vetdijshem per zgjidhjen e problematikave ne infrastrukture, sistemin vadites, bashkarisht te themi nje list te problemeve kyçe, ure, sistem vadites etj, t'i zgjidhim me aq mundesi financiare qe ka Bashkia Puke.

Faleminderit qe me degjuat jemi me drejtoren e Finances Fiqirete Latifi shperndarja ne investime do te jete e barabarte me njesite e tjera . Nuk i anashkalojme problematikat qe keni. Biseda sa me e çliret me njeri-tjetrin.

Buzhala fshat i braktisur, pa rruge, pa ure , vullnet i kryetarit te Bashkise. 2-3 veta problemaik s'kane rruge as ure.

Besnik Shkreli – zgjidhja e problemeve ne Dedaj – Mungese e sistemit vadites Rregullimi i rruges kryesore, ndertimi i ures.

Anetari i keshillit Alban Lleshi. →Tubucionet., 3 ura: 1. Buzhale ure Kombesore 2. Ukth lidh varrezaat. 3-Qerret i Vogel. nuk shkon mokina dhe as s'ka ure dhe as ruge kembesore.

Kol Guga Kryeplak Breg Qelez. 1 – Pjesa te komuna (njesia) inertet qe kane rene duhet fadroma per rrafshim. Qendra Shendetesore e kane derdhjen te njesia, te behet nje grope e vogel për ti mbledh inertet, ska puseta, eshte shembur dhe e kane mbush me dhe. Kalimi i ujit vadites eshte prishur kur eshte bere rruga ka dale jashte funksioni, Kerkoj Grope Skeptike. 2- ka qene një pusete, me bjen uje te shpija. 3- Uje vsadlites ne lagjen e Bregut një investim sado i vogel. - Rruge kembesore. Ura e Madhe – Markajt eshte rruge jashte funksioni

- Administratori: Rrethim i Varrezave te Buzhale, Ure kembesore ne Buzhale, ure ne Ukth, asfalt ne Mardhnaq asfaltim ne Bushat, Ure Kembesore ne Qerret i vogel, Tuba per Vadije

Nikoll Kolaj - Qerret i Vogel. Me Investimet eshte punuar pak nga kërkesat tona te shumta. Problem kryesor infrastrukture e rruges, bujqesi, blegtori, arsim.

Administratori ka qene gjithmone prezent ne problemet tona. Qerreti i vogel kemi nevoje per te rregulluar rrugen ne sherbim te njerezve, skemi uje, na duben tuba per ujesjelles , plakja e popullsise, ura don investim, tumbina te medha, sepse ngelet i bllokuar transporti i femijeve për në shkolla. Shpresojme te behen keto projekte.

Sokoli - Mos te ngurojme sipas propagandes se njerezve sepse investimet jane shtri në të gjitha njesite. Skemi arsye te tregohemi inferior ndaj propagandes se njerezve. Te jemi te vetedijshem per cdo ankese.

Nikall Kolaj -Eshte prish ura, skemi ku kalojme.

Abduinistratori - Jane tubat,

Denisa Meçi – Sekretare e Pergjithshme: kemi apliku dhe i propozojme serish te Fondi i Zhvillimit .

Klevis Lleshi - kemi nevoje per çakull, koder-Boje.

Protokolloj

Ana Marinaj



Sekretari i keshillit

Hazbi Terbuni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal : Konsultim publik : *Ne Njesine administrative Luf-Qerret*

Data : 25.11.2025 **Ora :** 13:00 **Vendi:** Salla e njesise administrative Luf

Numri i pjesëmarrësve : 32 vete 27 burra dhe 5 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026 , NJ.A.Luf-Qerret.

Pjesëmarrës : *Denisa Meci, sekretare e pergjithshme, Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, Sokol Gjoni drejtor i burimeve njerezore, Ndue Bushi administrator i Nj.A.Luf-Qerret.*

Takimi drejtohet nga Sokol Gjoni , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025 dhe prioritetet per vitin 2026, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Administratori Ndue Bushi

Faleminderit për pjesmarrjen. Ky takim është degjës për projekt Buxhetin 2026, investimet që do bëhen në vitin në vazhdim. Problematikat, reshjet e shiut në çdo fshat dhe lagje. Pune e mirë është bërë në shkollat, varrezat dhe rrugët. Nderhyrje në rrugën e Kaftallit, Vrrith. Nderhyrje në ura, rrugë, Vrrith-rruga, kanale anësore, urë kembësore, rruga drejt varrezave, rruga të lagjia e Hercekeve, demtime në ara në korthpule nga shirat. Tejkodër, rruga, demitime në shtëpi, fshati Gomsiqe, ura ka probleme, Kaftalla ka prishje pjesërisht rrugë. Fshati Luf, rruga, në Pla, ura të Bacajt dhe të Filipajt dhe mulliri i fshatit, rruga të varrezat. Qyteza Luf, prroni që lidh fshatin, Rrukaj, rruga dhe ura kembësore, rruga e Pletit, fshati Qerret rruga don nderhyrje. Duhet baze materiale.

Drejtori i burimeve njerëzore Sokol Gjoni: Pershendetje Ju falenderoj për pjesmarrjen. Orientojme për projekt-buxhetin 2026 listojme disa problemetika të njesise. Angazhimi i Bashkise dhe i kryetarit të Bashkise, kërkesat janë të mëdha, nevojat janë të mëdha, , perpiqemi t'u japim zgjidhje me aq mundësi sa kemi si Bashki. Bashkarisht në flasim për kërkesat tuaja. Ju degjojmë për ankesat tuaja.

Qerret: Deni Pemaj -kryetari i fshatit, ura dhe rruga, po ashtu uji pishëm mungon, mbushim ujë me bidona.

Hil Boci - Planifikimi nga Qeveria dhe mundësia nga të ardhurat e taksave të vendit (njesise). Migrimi dhe emigrimi i popullsisë të merren parasysh nga administratori dhe Bashkia. Bujqësia është zero, Arsimi ka probleme, ka nevojë për mjete mësimore didaktike, infrastruktura. Shëndëksia ka nevojë të jashtëzakonshme. Janë bërë përpjekje për investime, duhet të adresohen nga kryetaret e fshatrave dhe administratori.

Kryetari i fshatit Korthpule: Gjovalin Herceku – Problemet e fshatit Korthpule janë të shumta. Nderhyrje urgjente Rruga e kishës është e pakalueshme. Rruga e Lagjes Hercekve ka shembje të shumta nga shirat. kemi edhe disa kërkesa: studim nga ana e Bashkise për rezervuar vadites në Korthpule dhe rrethim i varrezave të Korthpules, zgjerim i varrezave), Disa rrugë jokryesore janë jashtë shërbimit të mirëmbajtjes. Rrjeti Elektrik i

amortizuar, çdo shi që bie fiken dritat, të transmetohet nga Bashkia të OSHE, kemi nevojë për Fadromë.

Faik Velia: Ura në Qerret., Çakull nuk më kanë sjellë. Nuk kemi ujë, Rregullimi i rruges.

Gjovalin Herceku-Problemi i tabelave nëpër fshatra, tabela informuese në fshatin Korthpule. Tabela në Dushkakuq.

Denisa Meçi Sekretare e përgjithme kemi kërkuar miniprojekte. janë dërguar të Fondit shqiptar i Zhvillimit të gjitha procedurat deri në ardhjen e materialeve, Angjelin Rrasa ; Rruga e Kaftalles, Shkolla e Gomsiqe ka ujë në oborrin e shkolles. Ska rrugë për në shtëpi dhe as të varrezat.

Sokol Gjoni do i bisedojmë, po i shenojmë të gjitha sepse nuk po më rezultojnë kështu, e më mëmë kërkesën tuaj do t'i marrim në konsideratë. Do dale Bashkia vete në terren, kemi ardhë për të mbledhë kërkesat tuaja dhe çdo problematikë.

Mbajti portokollin

Ana Marinaj



Sekretari i keshillit

Hazbi Terbuni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË

KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal i Konsultimit publik : *Ne Qytetin Puke*

Data : 26.11.2025 **Ora :** 13:00 **Vendi:** Salla e keshillit Puke

Numri i pjesëmarrësve : 31 vete 24 burra dhe 7 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultime publike per PBA 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026 , ne qytetin e Pukes.

Pjesëmarrës: *Rrok Doda kryetari i Bashkise , Denisa Meci , sekretare e pergjithshme, Sokol Gjoni drejtor i burimeve njerezore Fiqirete Latifi drejtore e Finances, Fiqirete Baci , specialiste finance, , Hazbi Terbuni sekretar I keshillit te bashkise, Lindita Hyseni drejtore e urbanistikes, drejtues te institucioneve, kryeplegte e fshatrave, qytetar.*

Takimi drejtohet nga Kryetari i Bashkise , ku u prezantuan sherbimet dhe investimet e kryera gjate vitit 2025 dhe prioritetet per vitin 2026, gjithashtu dhe shpjegime per:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën , diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohen janë si vijon :

Kryetari I Bashkise :

Qellimi i takimit eshte degjese publike me qytetaret per buxhetin 2026 dhe me kerku dhe adresuar problematikat qe kane krahas sherbimeve , pjesa kryesore e ketyre sherbimeve dhe investimeve ne sherbim te qytetareve. Keshtu dhe buxheti do te detajohet sipas grantit dhe te ardhurave , qe Bashkia Puke ka ne administrim. Me kete buxhet jane pagat, sigurimet shoqerore shpenzime dhe investime, do te perpiqemi te bejme projekte per investime ne sherbim te qytetareve .Ne takim kemi dhe figura qe perfaqesojne qytetin dhe per kete prezantojne dhe ankesa te qytetareve te Bashkise Puke.

Per vitin 2025 Bashkia Puke me perpjekje te vazhdueshme ka bere te mundur t'i jap forme dinjitoze qytetit tone. Ne 10 vjecarin e fundit investimet nuk jane adresuar aty ku duhet, kete vit u be e mundur sistemim-asfaltim i hyrjes se qytetit. Po keshtu u be investimi ne 5 pallatet ne hyrje te qytetit dhe sistemimi i tarracave. Po keshtu me fondet e emergjencave civile eshte nderhyre ne dy pallate, ne bodrumet e tyre.

Te tjera investime jane bere ne interes te qytetareve, per vitin 2026 do te perpiqemi te bejme dhe investime te tjera. Eshte ne vijim edhe tregu i qytetit ne bashkepunim me Bashkine Puke, do te behet dhe tregu i fshatareve. Me nderhyrje me donator po punohet edhe ne Muzeun e qytetit., qe eshte nje investim ne sherbim te qytetit.

Me Ministrine e kultures kemi fituar nje projekt per arredimin e muzeut , do te behet digjital. Ka student e turist qe kerkojne ta vizitojne muzeumin, i cili ka impakt ne ardhjen e turisteve.

Fale bashkepunimit me keshillin e Qarkut Shkoder eshte bere e mundur dhe investimi ne varrezat e qytetit, kerkese e vazhdueshme edhe e kryetarit te fshatit Puke, qe te sistemohen krahas rrethimit edhe disa rrugica. Krahas veshtersive po perpiqemi te realizojme edhe disa objektiva.

Tjeter investim eshte edhe shkolla 9-vjecare Migjeni, eshte lidhur kontrata dhe pritet te fillojne punimet., kjo eshte bere ne saje te performances se Bashkise Puke.

Ne takimet e zhvilluara me fondacione e donator Bashkia Puke ka fituar edhe nje grand performance, kjo ka ardhur nga puna e mire per hartimin e projekteve dhe planeve, ky vleresim sipas performances se Bashkise Puke, sherbimi ndaj qytetareve ka perfituar grande shtese.

Me fondin e zhvillimit kemi perfituar baze materiale per sherbime ne fshatra ne tumbina e te tjera materiale ne sherbim te qytetareve. Pra jemi ne pritje per te bere shume pune ne sherbim te qytetareve. Punimet jane transparente te publikuara ne faqen zyrtare te Bashkise dhe kemi bere nje pune cilesore ne te gjitha projektet e investuara. Kur eshte puna cilesore nuk ka nevoje te nderhyjme here pas here ne te njejtin objekt.

Nuk po permendim sherbimet , pasi ato jane te perditshme. Nuk mund te fitohen projektet , apo grande pa pasur plane dhe projekte. Planet dhe projektet I kemi bere pa shpenzime te fondeve te buxhetit , keto jane bere me administraten e Bashkise Puke dhe jemi radhitur ne 16 bashkite me te mira. Sa I perket turizmit jemi ne pritje te projekteve IPA3 me dy donator partner, jane projekte , qe do t'i japin nje ndihmese Bashkise.

Sa i perket pjeses sociale kemi projekte per moshen e trete dhe per personat me aftesi ndryshe. Po keshtu kemi perfituar edhe krevate per spitalin (22) dhe karroca per personat me aftesi ndryshe. Realiteti nuk fshihet, nese behet nje pune duhet te reklamohet.

Per vitin 2026 ka shume nevoja per pallatet dhe per njesite administrative. Do te fillojme me pallatet siper qytetit dhe me sistemin asfaltim te rrugeve dytesore., pa lene pas dore turizmin , bujqesine dhe rrjetin rural. Ne kemi realizuar rreth 70% per hartimin e planeve e projekteve te ndryshme, por duhet bere oponente teknike dhe kjo e rendon buxhetin.

Te tjera jane edhe bashkefinancimet, ku kemi perfituar paisje per zjarrefikset. Kemi paguar 10% per pjesemarrje ne investime , prandaj jemi detyruar te bejme ndryshime ne buxhet, sipas kerkesave te donatoreve te ndryshem. Mendojme te mos leme pas dore shtresat ne nevoje. Jane bere mjaft aktivite kulturore artistike , sportive me donator te ndryshem., si kampionati I boksit, Miss Bota dhe festivale te ndryshme. Te gjitha kerkojne nje angazhim motivues per hyrjen e ketyre evenimenteve. Do te perpiqemi te bejme investime dhe punesime te qytetareve per projekte te ndryshme. Dhenja me qera e pronave siguron te ardhura per Bashkine dhe komunitetin.

Lindita Hyseni: Kane te gjitha qytetaret ankesa per oxhaqet e pallateve, pasi oxhaqet nuk kane qene perfshire ne rikonstruksionet e pallateve.

Fiqirete Baci: Sistemimi dhe asfaltimi i rruges se lagjes Zezaj. Kur te behen pallatet siper te perfshihet e rruga Elez Hoxha e lagjes Zezaj.

Vinjola Kolici: Kerkojme nje rrethim per çerdhen e qytetit , pasi eshte shume e domosdoshme, pasi vijne e parkojne makinat deri te dera e çerdhes. Oxhaqet e çerdhes jane me problem.

Protokolloj

Fiqirete Baci



Sekretari I keshillit

Hazbi Terbuni

